



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:258150

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06373086

Ac.nr.950/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Adnan Konushevcu dhe Naime Ahmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K, nga P.....,rr. “B..... B.....”, nr. ...., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Dardania p.n. Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit L.S, juriste e diplomuar pranë të paditurës, me bazë juridike kompensim i të ardhurave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.990/2019, i datës 12.02.2020, në seancën jo publike të mbajtur me datë 23.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Dardania p.n. Prishtinë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.990/2019, i datës 12.02.2020, dhe lënda i kthehet gjykatës se shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.990/2019, i datës 12.02.2020, ka vendosur: “I.APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K, nga P....., rr.”B..... B.....”, nr. .... II. Detyrohet e paditura Posta dhe Telekomuni i Kosovës, sh.a me seli në Prishtinë, që paditësit A.K, nga P..... në emër të diferencës së pagës nga grada 4 në gradën 7 për periudhën prej 15.12.2013 gjer me 30.09.2015 t’ia kompensoj edhe atë : në emër të pagës neto shumë prej 4,669.93 €, për kontributin pensional në Trustin Pensional të Kosovës shumë prej 546.19 €, për tatimin në pagë për Administratën Tatimore të Kosovës në shumë prej 518.88 €, si dhe t’ia paguaj kamatën ligjore ligjore në lartësi ashtu siç: paguajnë bankat për

mjete të deponuara mbi një vit pa destinim të veçantë duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit gjegjësisht prej 12.02.2020 e gjer në pagesën definitive , dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës palës paditëse në shumë të përgjithshme prej 150.00 €, të gjitha këto kërkesa në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor”.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e goditur për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës, ashtu qe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe padia e paditësit te hedhet poshtë si e pasafatshme apo që të refuzohet si e papabazë padia dhe kërkesëpadia e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, të cilën e ka rregulluar dhe precizuar se fundi herë në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 20.09.2018, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura PTK, që në emër të ndryshimit të pagës në mes gradës 4 dhe 7 të paguaj shumën për periudhën prej 15.12.2013 deri 02.09.2015 edhe atë : në emër të pagës neto shumën prej 4,669.93 €, për kontributin pensional në Trustin Pensional të Kosovës shumë prej 546.19 €, tatimin në pagë në shumë prej 518.88 €, si dhe shpenzimet procedurale të cilat do të krijohen, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kërkesës nga padia, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve ndërgjygjëse ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, ku pas analizimit dhe vlerësimit të tyre ne përputhje me dispozitën ligjore të nenit 8 të LPK-së, e duke marrë për bazë edhe sugjerimet e Gjykatës se Apelit të dhëna më aktvendimi Ac.nr. 5556/18 i datës 22.03.2019, ka ardhur ne përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ku edhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2903/14, i datës 20.09.2018, duke vendosur me decidivishtë si në dispozitiv e të njëjtit.

Lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të goditur, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se sa i përket themelësisë se kërkesës se paditësit, fillimisht ka detyruar të paditurën që në afat prej shtatë ditësh t'ia sjell gjykatës sistematizimin e vendeve të punës dhe rregulloren e brendshme të paditurës me të cilat përcaktohen detyrat e punës edhe gradat e punëtorëve, mirëpo e paditura nuk ia ka sjellë gjykatës rregulloret e brendshme. Meqenëse e paditura gjykatës nuk ia ka sjellë aktet e brendshme, ndërsa me provat e nxjerra gjatë shqyrtimit kryesor ka gjetur se me aktvendimin mbi caktimin e lartësisë 01-1000-917/2012 të datës 07.03.2012 punëtores B.A e sistemuar në punët – detyrat e punës Zyrtar i arkëtimit të borxheve në njësinë Telekom i

Kosovës PTK sh.a, ku të ardhurat mujore i janë caktuar në gradën 7 duke filluar nga data 01.02.2012, me aktvendimin mbi caktimin e lartësisë 01-1040-915/2012 të datës 07.03.2012 punëtores F.R.B e sistemuar në punët – detyrat e punës Zyrtar i arkëtimit të borxheve në njësinë Telekom i Kosovës PTK.sh.a ku të ardhurat mujore i janë caktuar në gradën 7 duke filluar nga data 01.02.2012, ndërsa e paditura me aktvendimin mbi caktimin e lartësisë 01-531-2013 të datës 03.12.2013 paditësin A.K e ka sistemuar në punët – detyrat e punës Zyrtar i arkëtimit të borxheve në njësinë TIK ku të ardhurat mujore i janë caktuar në lartësi të gradës 4 duke filluar nga data 13.12.2013 ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pasi që dy punëtorët tjerë të paditurës për të njëjtin vend dhe pozitë të punës të cilin e ka pas edhe paditësi ju është caktuar paga mujore në lartësi të gradës 7 prej datës 01.02.2012, e në vazhdimësi, ndërsa paditësit për të njëjtin vend të punës me aktvendim të datës 03.12.2013 i është caktuar paga në lartësi të gradës 4, andaj i njëjti është i diskriminuar drejtë për drejtë në pagë.

Sa i përket lartësisë se kërkesëpadisë për ta bërë llogaritjen e të ardhurave personale për periudhën kontestuese, në cilësi të provë ka nxjerrë dhe i ka fal besimin ekspertizës financiare të punuar nga eksperti gjyqësor financiar Pr. Dr. A.B me datë 31.05.2018, në bazë të se cilës ka vërtetuar se sikur paditësi të mos diskriminohej në pagë nga e paditura për periudhën kontestuese prej datës 15.12.2013 e deri me 30.09.2015 do të realizonte të ardhura personale në shumën siç është cekur në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimin për parashkrim gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk qëndrojnë, pasi që gjykata në bazë të provave të administruara ka gjetur se paditësi e ka parashtruar padinë në gjykatë brenda afatit ligjor të parapara në nenin 87 të Ligjit të Punës, prandaj nga kjo bazë dhe në mbështetje të nenit 5 dhe 55 të Ligjit të Punës lidhur me nenin 4 pika c dhe 8 të Ligjit kundër Diskriminimit (nr. 2004/3), gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar. Vendimin mbi kamatën e ka marrë konform nenit 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës konform nenit 494 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate në rastin konkret gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka për rrjedhojë ka pas edhe zbatimin e gabuar të drejtës materiale.

I themelë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e cila për rrjedhojë ka pas edhe aplikimin e gabuar të ligjit material, pasi që Gjykata e Apelit më shikim në shkresë të lëndës konstaton se paditësi me kontratën e lidhur me të paditurën për kohë të pacaktuar me nr. 01-4061/09, e datës 22.07.2009 ishte punësuar në pozitën „ Punëtor sigurimi “ në lokacionin PTK headquarters në Prishtinë më lartësi të pagës sipas gradës 4.

Me aktvendimin mbi risistemimin e punëtorit nxjerrë nga e paditura me nr. 01-531/2013 i datës 03.12.2013 paditësi nga pozita „ Punëtor sigurimi “ të cilën e kishte pasur sipas kontratës me nr. 01-4061/09, e datës 22.07.2009, sistemohet në pozitën „ Zyrtar për arkëtim të borxheve “ me lartësi të pagës sipas gradës 4, gradë kjo të cilën e kishte pasur edhe sipas pozitës së mëhershme.

Më të njëjtin aktvendim, me pikën IV shprehimisht ishte përcaktuar se ky aktvendim është pjesë përbërëse e Kontratës se punës nr. 01-2880-1797 e datës 20 Tetor 2011.

Mbi bazën e këtyre provave, sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit ne shqyrtimin kryesor të mbajtur tek gjykata e shkallës së parë, e njëjta gjykatë nuk ka mundur te hetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë faktet se a e kishte kundërshtuar paditësi vendimin e nxjerrë nga e paditura me nr. 01-531/2013 i datës 03.12.2013 përmes se cilit paditësi nga pozita „ Punëtor sigurimi “ të cilën pozitë e kishte pasur sipas kontratës me nr. 01-4061/09, e datës 22.07.2009, sistemohet ne pozitën „ Zyrtar për arkëtim të borxheve “ ku lartësia e pagës i caktohet sipas gradës 4, apo i njëjti nuk e kishte kundërshtuar këtë vendim, me çka edhe rrjedhimisht ishte pajtuar më lartësinë e pagës sipas gradës 4, pasi qe ne shkresa të lëndës nuk ka prova se paditësi e kishte goditur një vendim të tillë nxjerrë nga e paditura, sa i përket qoftë pozitës në të cilën ishte risistemuar, qoftë sa i përket lartësisë se pagës se caktuar sipas gradës 4.

Përveç tjerash kur analizojmë dhe vlerësojmë aktvendimin mbi ri sistemimin e paditësit nxjerrë nga e paditura me nr. 01-531/2013 i datës 03.12.2013, me pikën IV te të njëjtit aktvendim qartë konstatohet se ky aktvendim del te jetë pjesë përbërëse e Kontratës se punës nr. 01-2880-1797 e datës 20 Tetor 2011, me çka rrjedhimisht mund të kuptohet se ne mes paditësit dhe të paditurës veç ka qenë e lidhur edhe një kontratë tjetër e punës, pas asaj e cila ishte lidhur fillimisht në mes tyre me nr. 01-4061/09, e datës 22.07.2009, mirëpo në shkresa të lëndës nuk ka dëshmi se gjykata si provë ka administruar këtë kontratë pune, më qëllim qe te mund te vërtetohej se çka saktësisht ka mundur të përmbajë kjo kontratë pune, sa ka qenë i caktuar koeficienti i lartësisë se pagës sipas kontratës dhe a ishte pajtuar paditësi apo jo më kushtet e caktuara sipas kësaj kontrate, apo jo, aq me tepër kur kontrata për palët çdoherë konsiderohet se ligj për të njëjtit.

Përfundimi i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë se kërkesëpadia e paditësit ka dal si e themeltë duke ju referuar raporteve nga marrëdhënia e punës qe e paditura ka pas me disa prej kolegëve të punës se paditësit, më të cilët kishte hyrë ne raporte pune për pozitën e njëjtë më të cilën edhe paditësi ishte risistemuar sipas vendimit të nxjerrë nga e paditura me nr. 01-531/2013 i datës 03.12.2013, sipas Gjykatës se Apelit është përfundim i gabuar sepse marrëdhënia e punës e themeluar në mes te paditurës më punëtorët tjerë është raport i cili mund te prodhojë efekt vetëm në mes tyre, por jo edhe ne mes personave tjerë siç ne rastin konkret kemi të bëjmë më këtu paditësin.

Mbi bazën e një rrethane te tillë, gjykata e shkallës së parë është dashur qe administrimin e provave te bëjë në drejtim të vërtetimit të fakteve kontestuese qe lidhen me raportin nga marrëdhënia e punës qe e paditura e ka pas me paditësin dhe a është shkelur apo jo ai raport i marrëdhënies se punës nga e paditura në dëm të palës paditëse, qoftë sa i përket pozitës në të cilën ishte caktuar qoftë sa i përket lartësisë se te ardhurave mujore, mbi bazën e të cilës shkelje për të paditurën do te linde detyrimi i kompensimit te të ardhurave të cilat ka pas për detyrim qe t'ia paguante muaj për muaj.

Te gjeturat e konstatuara si më lartë aktgjykimin e ankimuar si te tillë e bëjnë jo te drejtë dhe pa mbështetje ne ligj, me çka i njëjti aktgjykim u dashtë qe te priset dhe lënda ti kthehet gjykatës se shkallës së parë ne rivendosje, e cila ne riprocedurë udhëzohet qe duke marrë për bazë shkeljet

e konstatuara si më lartë përmes provave të propozuara të hetojë drejtë faktet se përpos kontratës së datës së lidhur në mes paditësit dhe të paditurës më nr. 01-4061/09, e datës 22.07.2009, në mes tyre a ishte lidhur kontratë tjetër apo jo, dhe nëse po cila ishte ajo kontratë dhe çka ishte përcaktuar saktësisht më të njëjtën, pra cilat ishin të drejtat dhe detyrimet për palët kontraktuese.

Në riprocedurë gjykata poashtu të kërkoj që të sqarohet çështja e kontratës me nr. 01-2880-1797 e datës 20 Tetor 2011, të cilës ju ka referuar e paditura me pikën IV të aktvendimin të nxjerrë nga ajo mbi ri sistemimin e paditësit në vendin e punës „Zyrtar për arkëtim të borxheve “ dhe nëse veç ka qenë e lidhur një kontratë e tillë në mes ndërgjyqësve gjykata të kërkoj nga të njëjtit që ti prezantohet gjykatës më qëllim që ajo të mund të administrohet si provë, aq me tepër kur me pikën IV të aktvendimin të nxjerrë mbi ri sistemimin e paditësit në vendin e punës „Zyrtar për arkëtim të borxheve” është theksuar se ky vendim është pjesë e të njëjtës kontratë, më qëllim që përmes shikimit në të njëjtën kontratë të mund të hetohet drejtë se cilat ishin të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës së lidhur në mes këtu ndërgjyqësve.

Gjykata po ashtu në riprocedurë përmes provave të nxjerra, nëse veç ekziston kontrata e punës me nr. 01-2880-1797 e datës 20 Tetor 2011, dhe të njëjtën mund ta administroj si provë, të hetoj edhe rrethanat se a ishte pajtuar paditësi më të njëjtën kontratë apo jo, dhe a ishte pajtuar apo jo edhe me vendimin për risistemim me nr. 01-531/2013 i datës 03.12.2013 i cili na rezulton se është pjesë përbërëse e të njëjtës kontratë, që pastaj përmes hetimit të drejtë edhe të rrethanave dhe fakteve tjera kontestuese, të ketë mundësi që të bëjë një vendim të drejtë i cili para se gjithash do të ketë mbështetje në provat shkresore dhe do jetë i bazuar në ligj.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 paragrafi 1 pika c) të LPK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 950/2022, me datë 23.10.2024.

Kryetari i kolegjit  
Qerim Ademaj, d.v